

## NJËSIA JURIDIKE E CENSIT TË POPULLSISË DHE BANESAVE

### NJOFTIM

Në mbështetje të ligjit nr. 140/2020 “Për censin e popullsisë dhe banesave”, ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, dhe pikës 1/c dhe pikës 2 të nenit 5 të VKM nr.768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”, INSTAT kërkon oferta nga shoqëritë që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre menaxhimin e akomodimit të personave në shërbim hotelerie.

1. Shërbimi i akomodimit në hotele kërkohet sipas tabelës së mëposhtme:

Bashkia	Periudha	Sasia (Nr. Persona)	Nr. Dhomave për akomodim	Numri i netëve/ person me Akomodimi + Trajtimi ushqimor (mëngjesi)
BERAT	04.09.2023 - 08.09.2023	27	14	5
DIBËR	04.09.2023 - 08.09.2023	19	10	5
DURRËS	04.09.2023 - 08.09.2023	38	20	5
ELBASAN	04.09.2023 - 08.09.2023	51	26	5
FIER	04.09.2023 - 08.09.2023	63	32	5
GJIROKASTËR	04.09.2023 - 08.09.2023	20	11	5
KORÇË	04.09.2023 - 08.09.2023	42	22	5
KUKËS	04.09.2023 - 08.09.2023	11	7	5
LEZHË	04.09.2023 - 08.09.2023	24	13	5
SHKODËR	04.09.2023 - 08.09.2023	37	20	5
TIRANË	04.09.2023 - 08.09.2023	103	52	5
VLORË	04.09.2023 - 08.09.2023	57	29	5

2. Shërbimi i akomodimit në hoteleri kërkohet sipas specifikimeve të mëposhtme:

#### Specifikime për akomodimin

- Akomodimi në dhomë të kryhet 2 persona të njëjtës gjini.
- Vend-akomodimi të jetë mundësisht brenda unazës së qytetit. Në rastet kur vend-akomodimi ndodhet jashtë unazës së qytetit, operatori ekonomik duhet të sigurojë transport për të akomoduarit në ambjentet e trajnimit që ndodhen brenda qytetit.

#### Trajtimin ushqimor për personat e akomoduar



- Mëngjesi:
  - Ofrohet cdo ditë në formë banketi nga ora 07:15 – 08:30.
  - Ushqimi të përmbajë produkte si qumësht, reçel, bukë, gjalpë, djathë, ujë natyral, etj.
- Darka
  - Pjatë e parë dhe e dytë, sipas menisë ditore të hotelit

3. Ofertuesi duhet të deklarojë se plotëson kriteret sipas formularit nr. 1 “Deklaratë”, bashkëngjitur njoftimit.

4. Ofertat sipas kriterëve të përcaktuara në këtë njoftim, duhet të jetë sipas formularit të ofertës **Formularit nr. 2** bashkëngjitur këtij njoftimi dhe të paraqiten në zarf të mbyllur, jo më vonë se data 10 Gusht 2023, ora 10.00 në adresën: Instituti i Statistikave, Rr. Vllazen Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative nr. 2, 1017, Tiranë.